

**Sigurimi i vazhdimësisë dhe sigurisë së prodhimit të perimeve në Kosovë**

FAQE 2

**Ndikimi ekonomik i COVID-19 në sektorin e turizmit në Kosovë**

FAQE 3

**Si po e përballojnë operatorët turistikë në Kosovë gjendjen e krijuar nga pandemia?**

FAQE 4

2020  
MAJ

# BULETINI.

PROMOVIMI I  
PUNËSIMIT NË  
SEKTORIN PRIVAT



## #POSITIVENEWS në kohëra sfiduese

Në fillim të vitit 2020, “mbyllja” dhe “izolimi” nuk ishin fjalët që do të kishim përdorur për atë që mendonim se ky vit do të sillte. Gjendja e shkaktuar nga COVID-19 në të gjithë botën shumë shpejt i përballi të gjitha shoqëritë me të njëjtën stuhi. Të gjithëve na u desh të përshtatemi dhe të hartojmë strategji për t'u ballafaquar me kërcënimin nga pandemia dhe me ndikimin e saj në çdo aspekt të jetës.

Thuhet se “kohërat e pazakonta kërkojnë masa të pazakonta”. Këto ditë të vështira mund të kenë rezultuar edhe në sfida personale dhe profesionale. Por nëse e shohim me sy pozitiv, kohëra si këto shpalosin aftësitë që kanë individët dhe ekipet për të gjetur mënyra kreative për të reaguar dhe për t'iu përshtatur rrethanave të reja në mënyrë që të vazhdojmë të punojmë drejt qëllimit të përbashkët për krijim të mundësive në vendet ku vepron Swisscontact.

Projekti Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Kosovë reagoi shpejt ndaj kësaj krize

globale me qëllimin për ta menaxhuar gjendjen dhe për të zbutur pasojat. Sfida më e madhe nga muaji mars ishte të mësoheshim me zhvendosjen nga puna e zakonshme në hapësirën virtuale. Dhe për të vazhduar punën për impakt, duke iu përshtatur realitetit të ri.

Plotësimi i nevojave të menjëhershme për ushqim, sidomos ushqim cilësor për njerëzit, është një nga shqetësimet kryesore. Në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e sektorit të Ushqimit dhe Përbërësve Natyrorë, aktivitetet u zhvendosën drejt përkrahjes së nismave që sigurojnë vazhdimësinë dhe sigurinë e prodhimit të perimeve në Kosovë, edhe për tregun, edhe për përpunuesit. Lajmet nga ky sektor kanë qenë pozitive dhe inkurajuese. Lexoni më shumë në **Faqen 2**.

Me mbylljen që pasoi në të gjithë globin, industria e turizmit dhe udhëtimeve pësoi goditje shumë të rëndë dhe Kosova nuk bëri përjashtim. Në mars, PPSE përgatiti një raport “Ndikimi ekonomik i pandemisë së COVID-19 në sektorin e hotelierisë

dhe akomodimit në Kosovë” që iu përcoll Ministrisë së Financave dhe Transfereve në përkrahje të planifikimit të tyre për masat zbutëse për këtë sektor me rëndësi të ekonomisë. Lexoni më shumë në **Faqen 3**.

**Projekti PPSE me një arritje të rëndësishme**

Më 26 mars 2020, Komiteti i Donatorëve për Zhvillimin e Ndërmarrjeve (DCED) e përgëzoi publikisht PPSE për "auditim shumë të suksesshëm të sistemit të matjes së rezultateve në përputhje me standardin DCED." Ky konkluzion është moment i rëndësishëm drejt qëllimit gjithëpërfshirës të projektit: NVM-të veprojnë në sektorë ekonomikë të mirëorganizuar dhe gjithëpërfshirës, ofrojnë rritje të punësimit të qëndrueshëm për gratë dhe burrat. Për më tepër, konkluzioni i DCED përsërit bindshëm vlerën që ka mbështetja e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim për rritjen ekonomike të Kosovës.

# INFORMATAT KRYESORE NGA PUNA JONË

## Sigurimi i vazhdimësisë dhe sigurisë së prodhimit të perimeve në Kosovë

■ Fokusi aktual i mbështetjes së PPSE-së në sektorin e Ushqimit dhe Përbërësve Natyrorë është bujqësia e kontraktuar. Ky fokus plotësohet me shërbimet dhe aktivitetet për më shumë qasje të fermerëve në fidanë cilësorë dhe me çmime të përballueshme për të rritur kapacitetet e prodhimit modern të fidanëve në Kosovë. Që nga fillimi i Fazës II në vitin 2017, PPSE ka përkrahur dy fidanishte të specializuara: Fidanishtja e Godancit dhe Agrobora. Kjo përkrahje ka përfshirë bashkë-financimin, teknologjinë, ndarje të njohurive nga ekspertët në mënyrë që fidanishtet të operojnë me efikasitet.

**Në Fazën II u angazhuan 587 fermerë shtesë në përgjithësi në sistemin e bujqësisë së kontraktuar dhe janë shfrytëzuar rreth 1,000 hektarë shtesë.**

Në muajt e fundit, lajmet nga partnerët tanë nga sektori i prodhimit të fidanëve kanë qenë pozitive dhe inkurajuese. Plotësimi i nevojave të menjëhershme për ushqim ka qenë aktiviteti kyç i tyre. Me fjalë të tjera, prodhuesit e fidanëve dhe rrjeti i fermerëve të kontraktuar kanë siguruar vazhdimësinë dhe sigurinë e prodhimit të perimeve në Kosovë, si për tregun, ashtu edhe për përpunuesit.

Fehim Rexhepi, nga qendra grumbulluese Agrocelina thotë, “Këtë vit, situata me fermerët e kontraktuar është shumë më e mirë dhe fidanët janë të një cilësie edhe më të lartë.” Agrocelina ka nënshkruar kontratë me prodhuesin e specializuar të fidanëve Fidanishtja e Godancit për 200,000 fidanë trangujsh. PPSE stimulon fermerët e kontraktuar përmes Agrocelinës duke mbuluar €0.03 për çdo fidan. Pjesa e mbetur mbulohet nga Agrocelina



dhe fermerët. “Jam shumë i kënaqur me cilësinë e fidanëve. Çmimi është i arsyeshëm dhe duke pasur parasysh situatën e krijuar nga COVID-19, Agro Celina na ka mundësuar që t’i paguajmë fidanët me prodhimin tonë” thotë Robert Skeli, familja e të cilit zotëron një serë në Novosellë, Gjakovë dhe kanë marrë 10,000 fidanë trangujsh.

Për Skender Ramadanin nga Fidanishtja e Godancit, “ky bashkëpunim mundëson prodhim të sigurt të perimeve që do të plotësojnë nevojat ushqimore të popullatës, por edhe ato të përpunuesve të ushqimit.” Në kuadër të të njëjtit bashkëpunim me PPSE, ai ka nënshkruar kontratë edhe me kooperativën Krusha e Madhe për 250,000 fidanë për specia.

Në mars, më pak se një vit pas lansimit të aktivitetit, Agrobora ishte gati për shpërndarjen e 400,000 fidanëve të parë për perime tek 25 pronarët e kontraktuar të serave më të mëdha në 9 komuna në Kosovë. Në prill, PPSE dhe Agrobora nënshkruan një marrëveshje partneriteti për sigurimin e fidanëve të perimeve me çmim të reduktuar për 7 ferma. Sasia është deri në 916,000 fidanë për specia, tranguj, presh dhe brokoli. Sipërfaqja totale e kultivimit do të jetë rreth 14.1 hektarë. E vetmja përgjegjësi e fermerëve do të jetë të kultivojnë fidanët.

Ky aktivitet i prodhimit të fidanëve të specializuar për fermerët e kontraktuar është arritje e rëndësishme për të krijuar prodhim të qëndrueshëm të fidanëve në vend dhe për vazhdimësinë e zgjerimit të sistemit të bujqësisë së kontraktuar, që rrit sigurinë financiare të fermerëve.





## Ndikimi ekonomik i COVID-19 në sektorin e turizmit në Kosovë

■ Me masat që u morën nga mesi i muajit mars 2020 për kufizim dhe ndërprerje të lëvizjeve dhe aktiviteteve afariste edhe në Kosovë, ashtu si në mbarë botën, për shkak të pandemisë së COVID-19, sektorë si turizmi, udhëtimet, hoteleria dhe gastronomia kanë pësuar goditje të rëndë. Ende nuk ka vlerësime të sakta se çfarë ndikimi do të ketë kjo periudhë në këta sektorë të ekonomisë së Kosovës, por shifrat e para tregojnë se rikthimi në nivelin para muajit mars do të jetë proces i gjatë dhe aspak i lehtë.

Më 3 prill 2020, Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT) e Republikës së Kosovës miratoi dhe publikoi Planin Operacional Për Pakon Fiskale Emergjente. Kjo pako ka për qëllim sigurimin e mbështetjes financiare për biznese në vështirësi për shkak të uljes apo ndërprerjes së aktivitetit të tyre pas gjendjes së krijuar në vend nga pandemia. MFT nuk i ka shtjelluar masat sipas sektorëve të ekonomisë, por ka shkuar me qasjen për t'i mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme duke subvencionuar pjesërisht humbjet dhe pagat e punëtorëve për dy muaj: mars dhe prill.

Para shpalljes së kësaj pakoje, projekti Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE) i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bash-

këpunim në Kosovë punoi një raport mbi [“Ndikimin Ekonomik të Pandemisë COVID-19 në Sektorin e Hotelierisë dhe Akomodimit në Kosovë”](#). Ky raport iu dorëzua Ministrisë së Financave dhe Transfereve në Kosovë, për të mbështetur planifikimin e tyre për masat lehtësuese ekonomike për këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë.

Sipas këtij raporti nga projekti PPSE, një përllogaritje e përafërt e ndërprerjes dy-mujore të sektorit të hotelierisë dhe akomodimit mund të ketë këtë ndikim:

- më shumë se 12,000 punonjës joaktivë në rrezik të humbasin vendet e punës dhe të mbeten pa të ardhura;
- të punësuarit në këtë sektor do të humbin një shumë totale mbi 6 milion EUR në paga;
- 3,683 ndërmarrje të vogla dhe të mesme ndikohen drejtpërdrejt me rreth 13 milion EUR humbje në qarkullim, dhe
- për shkak të pasivitetit të sektorit të hotelierisë dhe akomodimit, ndikimi i mëtejshëm në sektorin e ndërlikur mund të jetë më shumë se 10 milion EUR.

**Artikulli u botua së pari në revistën Albinfo, numri i muajit maj 2020**



## A E KENI DITUR...?

A

...mbyllja e veprimtarive për shkak të pandemisë nuk i pengoi fermerët në Kosovë që të jenë aktivë? Agropeti, kompani që merret me grumbullimin dhe kultivimin e produkteve puçore jodrusore dhe bimëve mjekësore aromatike ka vijuar me planet e veta për kultivimin e hithrave. E gjithë veprimtaria e Agropetit zhvillohet duke respektuar në mënyrë strikte të gjitha masat që pengojnë përhapjen e mëtejshme të virusit. Petrit Shabani, pronar, thotë: “Kultivimi i bimëve mjekësore aromatike do të ndikojë gjithashtu në mbajtjen e njerëzve të punësuar dhe në krijimin e vendeve të reja të punës, pra në të ardhura për ne dhe fermerët tanë të kontraktuar. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në një kohë si kjo kur ekonomia lokale dhe globale po përballen me sfida”.

B

...Parku Germia në Prishtinë, një nga vendet më të preferuara në natyrë për banorët e qytetit, së shpejti do të sjellë një hapësirë më shumë për argëtim dhe aventurë në natyrë për vizitorët e të gjitha moshave? Parku i Aventurave IN-Nature është projekti më i ri për turizëm i Komunës së Prishtinës, një bashkëinvestim me Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Planifikohet të ketë 53 elemente dhe 6 nivele për ngjitje për deri në 90 vetë në të njëjtën kohë. Parku i Aventurave do të ketë edhe 6 zipline me gjatësi dhe nivel vështirësie të ndryshme si dhe një kafene prej druri. Diçka e këndëshme për kur mbyllja të përfundojë.

C

...muajve të fundit, kërkesa për lëngjet e freskëta me fruta të shtrydhura që i prodhon kompania Kastrioti është rritur dukshëm? Si rezultat, Afërdita Murati, pronarja, dhe ekipi i saj, kanë punuar me më shumë ndërrime për t'i përmbushur të gjitha kërkesat e klientëve për lëngje të freskëta nga aronia, boronicat e egra dhe manaferrat. Gjithashtu, Afërdita ka angazhuar dhe dy punëtorë shtesë me orar të pjesshëm që t'i ndihmojnë. Falë kapaciteteve të shtuara përpunuese me makineri për mbushjen e shisheve dhe mbylljen e kapakëve që kompania i siguroi me përkrahjen e PPSE, plotësimi i kërkesës së rritur është menaxhuar më lehtë.

D

...së shpejti, do të keni mundësinë të përjetoni emocionet e hedhjes “bungee jumping” edhe në Kosovë? Në fakt, këtë përvojë mund ta bëni edhe më emocionuese duke u hedhur jo një herë, por sa herë të doni, nga pika të ndryshme në vend. Miku i ngushtë në këtë aktivitetet do të jetë kamera GoPro, pasi ju mundëson t'i tregoni familjes dhe miqve guximin për t'u hedhur dhe argëtimin. Ky është produkti më i ri që do të shtohet në listën e gjërave për të bërë në Kosovë. Produkti menaxhohet nga Dinarica Journey me përkrahjen nga PPSE.

# MODELI PËR NDRYSHIM

## Si po e përballojnë operatorët turistikë në Kosovë gjendjen e krijuar nga pandemia?

Arsim Rexhepi është themelues i Balkan Destination, një operator turistik që sjell turistë të huaj në Kosovë dhe kryesisht organizon vizita për kulturë, gastronomi, traditë dhe përditshmëri të jetës në vend. “Tregu ynë është kryesisht i huaj. Grupet tona fillojnë nga fundi i i prillit dhe maji dhe kjo periudhë do të duhej të ishte shumë e ngarkuar për ne. Mbyllja e aktiviteteve për shkak të pandemisë ka ndikuar negativisht, sepse të gjitha grupet deri në qeshor janë anuluar dhe në fakt, ne nuk e dimë as se çfarë do të ndodhë me grupet e shtatorit dhe tetorit” thotë ai.

Për anulime të grupeve me turistë të huaj tregon edhe Virtyt Gacaferi, themelues i Balkan Natural Adventure, ofruer i shërbimeve turistike në Kosovë, por që mbulon dhe vende të tjera në Ballkanin Perëndimor. “Kemi marrë shumë anulime nga klientët të huaj. Për ne, 90% e klientëve vijnë nga shtetet e BE-së, Australia, SHBA dhe Azia. Nuk presim ta fillojmë sezonin e verës këtë vit. Nëse mund t’ia nisim punës në nëntor, për ne është mirë”.

Për t’iu përshtatur rrethanave të krijuara dhe jashtë kontrollit të bizneseve, Balkan Natural Adventure është fokusuar në aktivitete të reja gjatë stinës së verës me fokus tek vizitorët vendas. “Po orientohemi nga tregu vendor. Jemi duke përgatitur ofertë të mirë dhe të përbal-

lueshme për qytetarët kosovarë. Për shembull kemi bjeshtë, ku guidat tanë udhëheqin çaj, kërpudha e boronica. Po përpiqemi të gjejmë modele që ta zëvendësojmë punën tonë të deritanishme, me oferta për klientë që janë ndryshe nga klientët tanë të zakonshëm” thotë Virtyt Gacaferi.

Në të vërtetë, këtë vit pritet që fokusi të jetë tek vizitorët vendorë dhe krijimi i paketave turistike brenda vendit, të përshatshme për këtë klientelë të re, por edhe me çmime të përballueshme për ta. Ndërprerja e aktiviteteve ekonomike në vend ka sjellë ulje të të hyrave për familje dhe udhëtimet apo pushimet jashtë shtetësisë këtë vit do të jenë edhe më shumë luks se zakonisht. Shumë operatorë turistikë po shfrytëzojnë këtë periudhë pa aktivitete për të



rikonceptuar modelet e tyre të biznesit dhe për të krijuar oferta tërheqëse për vizitorët vendorë.

Ndërkohë që masat kufizuese duket se po shkojnë drejt relaksimit, Kosova po bëhet gati me oferta të turizmit për njerëzit e vet. Është koha për ta dashur edhe më shumë Kosovën dhe për t’i dhënë jetë të re potencialit turistik të vendit tonë.



Rr. Sylejman Vokshi Nr.42 |10000 Prishtinë, Kosovo  
Tel: +383(0)38220403  
email: [ppseinfo@swisscontact.org](mailto:ppseinfo@swisscontact.org)  
website: [www.ppse-kosovo.org](http://www.ppse-kosovo.org) and  
[www.swisscontact.org/kosovo](http://www.swisscontact.org/kosovo)  
[www.facebook.com/ppse.kosovo](https://www.facebook.com/ppse.kosovo)  
[https://twitter.com/PPSE\\_Kosovo](https://twitter.com/PPSE_Kosovo)  
<https://www.instagram.com/ppsekosovo/>

### Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat

Projekti Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim implementohet nga Swisscontact dhe Instituti Riinvest.

